



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 104, Datë 31.05.2024

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË
“FAETHON” SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 dhe 37, pika 2, gërma “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, gërma “a”, 5, pika 1, gërma “a”, dhe 10, pikat 1 dhe 3 të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma “a” të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.05.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1125/1 prot., datë 29.05.2024, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi kërkesën e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

Konstatoi se:

- Shoqëria “FAETHON” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1125 prot., datë 21.05.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai, me kapacitet prodhues 93 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë.
- Nga shqyrtimi i këtij aplikimi vërehet se kërkesa për licencim, formati i aplikimit dhe shtojcat 1 A dhe 2 mbajnë vetëm një nënshkrim administratori, pa shënuar emrin e tij. Kërkesa për aplikim duhet të nënshkruhet nga administratori që përmban tagrat e përfaqësimit ligjor, duke cilësuar edhe emrin dhe mbiemrin e tij.
- Aplikuesi ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të Aneksit A të Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Po ashtu nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se aplikuesi ka plotësuar dokumentacionin në zbatim të përcaktimeve të nenit 9 të Rregullores, për pikën 1.2, gërmat “a” dhe “d”; për pikën 1.3 gërma “c”; për pikën 2.1 gërmat “b”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2427 rep., nr. 1333 kol., datë 05.04.2024 “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 93 MW, i cili nuk është objekt koncesioni, dhe veprave ndihmëse, në zonën kadastrale nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë, nga shoqëria “FAETHON” sh.p.k.”; po ashtu, shoqëria është pajisur me Deklaratën Mjedisore, lëshuar më 04.10.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit, me nr. AN310820230006, për të zhvilluar projektin për ndërtimin e parkut fotovoltaike në Libohovë; si dhe është pajisur nga shoqëria OST sh.a. me miratimin në parim për lidhjen e parkut fotovoltaike Libohovë me rrjetin e transmetimit, nëpërmjet shkresës nr. 2041/1 prot., datë 20.04.2023.
- Nga ky aplikimi nevojitet të plotësohet informacioni/dokumentacioni si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1.2. Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dëshminë e penalteti të lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për shoqërinë “FAETHON” sh.p.k. dhe për të tre administratorët e saj.
- **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë strukturën organizative në format origjinal, ose fotokopje të njësuar me origjinalin.

Pika 1.3. Dokumentacioni financiar dhe fiskal

- **gërma “a”**: Aplikuesi duhet të depozitojë dhe vërtetimin për shlyerjen e detyrimeve ndaj organeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
 - **gërma “b”**: Aplikuesi duhet të depozitojë në ERE dokumentacionin përkatës për mbështetjen financiare, referuar vlerës së investimit në kontratën me MIE-n.
 - **gërma “c”**: Aplikuesi duhet të depozitojë miratimin përfundimtar/marrëveshjen e nënshkruar me OST sh.a. për miratimin e pikës së lidhjes me rrjetin e transmetimit, si dhe informacionin/sqarimet përkatëse përse kërkesa e lidhjes është bërë me kapacitetin e instaluar 93 MWp, ndërkohë që në kontratën e nënshkruar me MIE-n dhe në Deklaratën Mjedisore ky kapacitet është 93 MW.
- Në kuadër të vlefshmërisë së Deklaratës Mjedisore (deri më 04.10.2025) dhe duke qenë se në shtojcën e të dhënave teknike shoqëria ka bërë me dije se punimet e centralit parashikohet të bëhen gjatë vitit 2024, ajo duhet të informojë/dokumentojë fillimin e punimeve.
 - Shoqëria duhet të paraqesë në ERE dokumentacion në lidhje me jetëgjatësinë e pritshme të centralit fotovoltaike.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “FAETHON” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik me kapacitet të instaluar 93 MW, me vendndodhje në Zonën Kadastrale Nr. 2444, Bashkia Libohovë, Qarku Gjirokastrë.
2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, të njoftojë shoqërinë “FAETHON” sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI